



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional në

“Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Ass. Gafur Muka
2. PhD. Egla Luca

Tetor 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit me karakter profesional në “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” ofruar nga Institucioni i Arsimit të lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 565 datë 27.06.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	- Shkresë MASR Nr. 7239/1 prot, datë 17.08.2018; - Shkresë MAS Nr. 2085/1 prot, datë 27.06.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 328, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	5 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve: (3 vitet e fundit)	78 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TËVLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit “Hidroteknikë, Ujësjetllës Kanalizime” ofrohet nga Institucioni i Arsimit të lartë Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës “UAMD”.

Universiteti “UAMD” përbëhet nga 5 fakultete (njësi kryesore) dhe 22 departamente (njësi bazë) si mëposhtë:

- Fakulteti i Biznesit (6 Departamente);
- Fakulteti i Edukimit (6 Departamente);
- Fakulteti i Studimeve Profesionale (4 Departamente);
- Fakulteti i Shkencave Politike Juridike (3 Departamente);
- Fakulteti i teknologjisë së informacionit (3 Departamente) .

Fakulteti i Studimeve Profesionale, njësia kryesore që ofron PS “Hidroteknikë, ujësjetllës Kanalizime”

përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detare;
- Departamenti i Shkencave Teknike e Mjeksore;
- Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës.
- Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën

Programi me karakter profesional 2 vjeçar “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime” i ofruar nga Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, është hapur për herë të parë në vitin akademik 2014-2015, sipas urdhërit Nr. 139, datë 20.06.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (evidenca 1). Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP) i cili është një nga pesë fakultetet e këtij universiteti, është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit me karakter profesional 2 vjeçar, “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime”.

Programi me karakter profesional 2 vjeçar, “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime” ofrohet në nivel njësi kryesore (FSP) dhe njësi bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është Departamenti Shkencave Inxhinierike dhe Detare (DSHID), i cili në bashkëpunim me njësitë e tjera akademike si dhe të strukturave ndihmës akademike administrative japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Vlerësimi i jashtëm për akreditimin e programit të studimit profesional në “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime”, të ofruar nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), si njësi mësimore e kërkimore universitare në Fakultetin e Studimeve Profesionale (FSP) të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) është kryer nga GVJ i cili, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi konsultimin dhe shqyrtimin e e Dosjes së Vetvlerësimit (DVV), e cila përmban rreth 143 dokumente duke u ndalur posaçërisht në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) si dhe dokumentet e tjera në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan, u formuluan dhe u formatuan pyetjet, që kishin të bënin me plotësimin e standardeve dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në institucion u krye në datat 5-6 qershor, sipas axhendës së hartuar nga ASCAL në dakordësi me GVJ dhe UAMD.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, përzgjedhi si vlerësues të jashtëm, Prof. As. Gafur Muka dhe PhD. Egla Luca, për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Pas vizitës në Institutin e Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksander Moisiu Durrës” (UAMD) GVJ, bazuar në gjetjet gjatë vizitës, dokumentacionin e DVV dhe plotësimeve të kërkuara nga GVJ, në respektim të kontratës me ASCAL, hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ) të cilin e dorëzon pranë ASCAL.

Më datë 18/09/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 15/150 Prot., datë 18/09/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 09.10.2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime (HUK)”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>IAL që ofron programin e studimit (PS) me karakter Profesional “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” është Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD. Mbështetur në dokumentacionin ligjor të kërkuar për hapjen e PS, ky institucion ka hartuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe, mbi këtë, bazë është miratuar hapja e PS me karakter Profesional “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime”, me VKM Nr. 565, datë 27.06.2013, ndërsa me Vendimin e MARS nr. 7239/1, datë 17.08.2018 është bërë riorganizimi i këtij PS me përmirësim të kurrikulës deri në masën 20%. Si vendimi për hapjen ashtu edhe urdhëri për riorganizimin janë mbështetur në nevojat e ekonomisë për specialistë të këtyre fushave me referencë interesat kombëtare dhe me synim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtar. GVJ konsultoi dokumentacionin ekzistues dhe konstaton përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 1 Urdher per hapjen e programit HUK-2013.</i> <i>Evidenca 3 Shkrese MASR_7239-1, 17.08.2018_riorg TA</i> <i>Evidenca 4 VSenati 83, 14.06.2018 HUK.</i> <i>Evidenca 6 Vendim DSID_12, 30.04.2018_HUK.</i> <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 56 Analizë tregu</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Referuar akteve rregullatore të UAMD, në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV), por edhe nga takimi me drejtuesit e njësisë baze dhe në nivel fakulteti, konstatohet se është e mirëpërcaktuar oferta dhe drejtimit akademike, të orientuara drejt disiplinave formuese (matematikë, fizikë, kimi,), profilizuese (Instalime hidraulike, Procese trajtim uji, Sisteme kanalizimesh, Rrjete teknologjike – furnizim me ujë , Hidroteknikë e zbatuar etj), dhe konkretizues (praktikë profesionale 1, praktikë profesionale 2). Universiteti, në të gjithë dokumentet strategjike, ka të shprehur qartë</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe</p>	<p>Referuar akteve rregullatore të UAMD, në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV), por edhe nga takimi me drejtuesit e njësisë baze dhe në nivel fakulteti, konstatohet se është e mirëpërcaktuar oferta dhe drejtimit akademike, të orientuara drejt disiplinave formuese (matematikë, fizikë, kimi,), profilizuese (Instalime hidraulike, Procese trajtim uji, Sisteme kanalizimesh, Rrjete teknologjike – furnizim me ujë , Hidroteknikë e zbatuar etj), dhe konkretizues (praktikë profesionale 1, praktikë profesionale 2). Universiteti, në të gjithë dokumentet strategjike, ka të shprehur qartë</p>

<p>Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>qëllimet dhe objektivat specifike, të cilët mbështesin programet e studimit, posaçërisht edhe PS “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime”. Konkretisht, referuar dokumentacionit për programin profesional “Hidroteknikë, Ujësjiellës Kanalizime”, konstatohet se përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me aktet rregullatore të institucionit, prioritetet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe Fakultetit të Studimeve Profesionale dhe, për më tepër, ato janë në linjën e zbatimit të strategjisë së UAMD dhe të Fakultetit të studimeve profesionale në veçanti.</p> <p>Me këtë program UAMD, merr detyrimin dhe përgjegjësinë e formimit të specialisteve hidroteknikë në përputhje me nevojat e tregut dhe kërkesat e ekonomisë kombëtare. Njëkohësisht Fakulteti i studimeve profesionale synon të jetë promotor i zbatimeve të modeleve të reja në këtë fushë, duke ndjekur zhvillimet aktuale dhe duke u përshtatur me perspektivat.</p> <p><i>Evidenca 12 Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025</i> <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>PS “Hidroteknikë, Ujësjiellës Kanalizime” është program i ofruar nga një universitet publik. Si i tillë hapja e tij është bërë mbështetur në kërkesat e tregut të punës dhe në strategjitë e zhvillimit kombëtar. Filluar nga viti 2013-2014 ai tashmë ka një përvojë gadi 10 vjeçare në plotësim të kërkesave të tregut. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi që për këtë PS ka patur gjithmonë kërkesa të shumta, çfarë kë sjellë që kuotat e ofruara të plotësohen qysh në fazën e parë të aplikimit nga maturantët. Aktualisht shkalla e punësimit ishte në masën 50-60% edhe pse shumica e të diplomuarve në këtë PS emigronin për tu punësuar jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 56 Analizë tregu</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Referuar akteve rregullatore, evidencave 43, 44 si dhe vizitës në institucion në takimin me personelin akademik, RVJ konstaton që institucioni ka kapacitetet e duhura akademike, po ashtu dhe përvojën e burimet e duhura edhe për ofrimin edhe për realizimin e këtij PS.</p> <p><i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i></p>

	<p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP</i> <i>Evidenca 44 Personeli DSID - te dhena + kualifikim</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe konsultimit të dokumentave të DVV, GVJ u informua që fusha e studimeve për PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” ishte në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSP si njësi kryesore dhe posaçërisht të Departamentit të Shkencave Inxhinierike Detare (DSID) si njësi bazë (përgjegjëse) çfarë është në përputhje me klasifikimin/ kodifikimin e programeve të studimit dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP</i> <i>Evidenca 44 Personeli DSID - te dhena + kualifikim</i> <i>Evidenca 49 Kodifikimi i programeve</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi GVJ vlerëson që PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” ofrohet në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e UAMD, ka burimet e nevojshme në fushën akademike, ka përvojë të konsoliduar në përmbushje të kërkesave të tregut dhe ka synime të qarta në ruajtjen e interesave e vlerave kombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Shet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Si program me karakter profesional, PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” është hartuar dhe mbyqyret nga UAMD kryesisht në linjë akademike e administrative duke siguruar marrëdhënie funksionuese brenda institucionit me koordinim të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, vënjen në dispozicion të ambienteve të përbashkëta si auditore e laboratore, realizimin institucional të marrëdhënieve me sipërmarrjet për kryerjen e praktikave mësimore si dhe interesimin për punësimin e studentëve. Për realizimin e këtyre aktiviteteve kishte përgjegjësi të adresuar qartë dhe analizë të vazhdueshme për cilësinë e kryerjes së tyre.</p>

	<p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 23 Organograma, struktura analitike e UAMD</i> <i>Evidenca 23 Organograma, struktura FSP</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga konsultimi i materialeve të DVV si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton që UAMD, për këtë PS, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi funksionale më biznesin dhe ndërmarrjen e ujësjellës kanalizimeve Durrës. Në këto firma zhvillohen praktikrat mësimore dhe prej tyre merren edhe lektorë me përvojë si PAK. Sa i takon marrëdhënieve me biznesin e huaj, GVJ u informua që shumica e të diplomuarve në këtë PS punësohen jashtë vendit dhe, në kërkesat e tyre për të ekuivalentuar studimet gjendet që shumica e krediteve të marra në këtë PS ekuivalentohen me ato që u duhen për të punuar në profesion jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 31 Marreveshje FSP me U Vlore+Luarasi+Kolegji prof. TR</i> <i>Evidenca 34,35,36 Marreveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Për PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime”, institucioni kishte nënshkruar marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme për realizimin e praktikave profesionale me ndërmarrjen e ujësjellës kanalizimeve Durrës. Në takimin me personelin akademik na u tha që kjo ndërmarrje i ka kapacitet e nevojshme për të plotësuar kërkesat e këtij PS lidhur me praktikrat profesionale. Kjo praktikë ka rezultuar mjaft e dobishme pasi kontrolli dhe përkujdesja për studentët janë të përqëndruara, po ashtu edhe pozicionet e angazhimeve të tyre janë në përputhje me kërkesat e programit. Për dobinë e këtij bashkëpunimi u shprehën edhe studentët në takimin që GVJ organizoi me ta.</p> <p><i>Evidenca 34,35,36 Marreveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ u informua për përftimet që kishte PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe konstaton që kryesisht marrëveshja me ndërmarrjen ujësjellës kanalizime Durrës është me vlerë jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale nga studentët por edhe në rivitalizimin e planit mësimor. Po ashtu edhe kontaktet me studentët e punësuar jashtë janë me shumë vlerë për të gjykuar masën e përshtatjes së programit të kësaj PS me kërkesat e tregut të jashtëm.</p>

	<i>Evidenca 34,35,36 Marreveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Për plotësimin e këtij kriteri UAMD kishte marrëveshje bashkëpunimi më të gjitha sipërmarrjet që lidheshin me diplomat e programeve të studimit me karakter profesional dhe dispononte statistika për punësimin e studentëve. <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 31 Marreveshje FSP me U Vlore+Luarasi+Kolegji prof. TR</i> <i>Evidenca 34,35,36 Marreveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>Evidenca 105</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD ka siguruar marrdhënie bashkëpunimi funksionale edhe për PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” kryesisht me biznesin vendas por indirekt edhe me tregun e jashtëm të punës, në përputhje me specifikat e programit të studimit dhe në interes të përmirsimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar Statutit dhe Rregullores së UAMD-së, GVJ konstaton se është përcaktuar qartë struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UAMD, që është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), për monitorimin e cilësisë dhe zhvillimin e mekanizmave të cilësisë, bazuar në rregulloren e saj. Nga takimi me NJSBC dhe titullarin e departamentit, stafin akademik dhe studentet, GVJ konstatoi se NJSBC bashkëpunon ngushtë me Fakultetin, departamentin përgjegjës për programin e studimit në fjalë. NJSBC në UAMD përbëhet nga dy sektorë: -Sektori i kurikulës dhe cilësisë -Sektori i çështjeve mësimore Në funksionimin e saj NJSBC në bashkëpunim me përgjegjësit e departamenteve organizonte monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies në të gjithë elementët e saj si në procesin e leksioneve, seminareve, punëve laboratorike dhe praktikës profesionale, sipas planit të punës të përcaktuar. GVJ konstati se NJSBC zhvillonte mekanizma të vlerësimit e të

	<p>monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Kjo realizohej nëpërmjet pyetësorëve/anketimeve vlerësuese për çdo lëndë, ku studenteve iu jepej mundësia të shpreheshin në mënyrë të lirë dhe të pavarur duke ruajtur anonimin. Rezultatet e këtyre vlerësimeve pasi grupoheshin dhe analizoheshin përbënin objekt analize në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti.</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 45 V Dekanati _10, 22.04.2021_komisi cilesise FSP</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nëpërmjet NJSBC, UAMD rezultoi se ka të organizuar në mënyrë funksionale sistemin e brendshëm të cilësisë, i cili funksionoi si më poshtë:</p> <p>Në monitorim, duke mbikëqyrur procesin e mësimin në të gjitha elementet e tij, duke mbledhur informacione dhe evidentuar probleme të ndryshme, duke organizuar anketime të vazhdueshme dhe në kushte anonimati me studentët për lektorët, lëndët dhe infrastrukturën. GVJ u informua që përpunimi i rezultateve të këtyre anketimeve bëhej në bashkëpunim me projektin CleanScore (Cilësi & transparencë).</p> <p>Në mbështetje të përmirësimit të cilësisë bëhej evidentimi i problemeve për të zgjidhur ato. Konkretisht, nëse nga anketimet rezultonte që një pedagog vlerësohej në masën 70% negativisht raportohej tek përgjegjësi i departamentit për të proceduar më tej.</p> <p>Në rolin e koordinatorit, kjo njësi angazhohej në një proces koordinimi për realizimin e të gjitha detyrave dhe objektivave që lidheshin me cilësinë jo vetëm nga një njësi (departament, apo fakultet), por edhe nga njësitë e tjera të fakultetit apo dhe universitetit. Konkretisht problemet që ngrinin studentët për përmirësimin e infrastrukturës synohej të zgjidheshin duke angazhuar të gjitha strukturat përgjegjëse në UAMB</p> <p><i>Evidenca 12 Plani i zhvillimit strategjik UAMD 2020-2025</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 45 V Dekanati _10, 22.04.2021_komisi cilesise FSP</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi interesimin e institucionit për të realizuar sa më shpejt procesin e akreditimit të jashtëm pasi, sipas dekanit të FSP, studentët preferonin të frekuentonin programe të akredituara. Sa u përket vlerësimeve krahasuese ato ndikoheshin kryesisht nga kërkesat e studentëve për të bërë ekuivalentimin e studimeve jashtë shtetit. Këto kërkesa kishin ndikuar në standardizimin e moduleve të procesit për të lëshuar suplemente</p>

e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	diplomash sa më të barazvlefshme me ato të vendeve ku studentët kërkonin të punësoheshin. <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Vlerësimi i rezultateve të anketimeve nëpërmjet projektit CleanScore (Transparencë dhe Cilësi) përbën një bazë të mirë për të nxjerrë tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. GVJ mësoi që në rastin e vlersimeve, personeli mësimdhënës kishte ankesa për vlersimin negativ të pyetjeve pa përgjigje, çka çoi në referimin e kësaj ankese në metodikën e vlersimit. <i>Evidenca 44 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 73 Rezultate anketimi</i> <i>RVB; Minuta takimi nëUAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë në PS "Hidroteknikë Ujësjetllës kanalizime" duke patur funksionale NjSBC, GVB, Zyrën e karrierës, Alumni etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>PS me karakter profesional “Hidroteknikë, Ujësjetel Kanalizime” është organizuar në lëndë të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 60 kreditesh në vit akademik (total 120 ECTS) dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike/ 4 semestra, me kohë të plotë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këto lloj programesh.</p> <p>Nga takimi me titullarët e fakultetit/ departamentit dhe RVB, GVJ konstaton se në hartimin e programit është shfrytëzuar përafrimi i programeve të studimit me ato të ofruara në universitete të tjera, duke sjellë një përfaqje dhe përshtatje të kurrikulës së këtij programi me ato të vendeve të tjera, për të mundësuar transferim studimesh apo punësim të të diplomuarve dhe në nivel ndërkombëtar. Kjo përfaqje bëhet edhe duke konsideruar kërkesat e studentëve, që suplementi i diplomës të ekuivalentohej sa më mirë me PS jashtë shtetit, në mënyrë që punësimi i tyre jashtë të mos kishte probleme. Struktura e programit të studimit me karakter profesional 2-vjeçar “Hidroteknikë Ujësjetel Kanalizime”, bazuar në objektivat e programit, përgatit studentët me aftësi dhe kompetenca praktike profesionale për të qenë konkurrues në tregun e punës. Këto aftësi merren nëpërmjet formave të mësimdhënies me orientim praktik (detyra kursi, laboratore, workshope) apo praktikës mësimore dhe asaj profesionale që janë pjesë përbërëse e programit të studimit, ku shpërndarja e ngarkesës së formimit teorik dhe atij praktik është në përputhje me legjislacionin e fuqi për këto lloj programesh.</p> <p>Programi i studimit ofron një gamë të gjerë njohurish në kategorinë e lëndëve të formimit të përgjithshëm A (15%), në kategorinë e lëndëve karakterizuese profesionale B (43 %), në kategorinë e lëndëve integruese të fushës C (13 %), dhe në kategorinë e lëndëve të aftësisimit informatik dhe praktikës profesionale D (15 %) dhe provim final E (5 %).</p> <p><i>*LIGJ Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)”</i></p> <p><i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</i></p> <p><i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i></p> <p><i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 12

	<p><i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në institucion konstatohet që PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” synon formimin e shprehive të veçanta në profesionin e hidraulikut dhe specialistit të ujësjellës kanalizimeve duke i paisur studentët me njohuritë e nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në profesionet e tyre si dhe duke potencuar aftësi dhe kompetenca bashkëkohore për njohjen dhe përdorimin e teknologjive të reja. Në takimin me studentët GVJ u informua lidhur me vlersimet e tyre për programin e studimit dhe konstatoi pëlqimin e tyre ndaj tij. Sugjerimi që ata kishin ishte për reduktimin e mundshëm të ngarkesës teorike dhe shtimin, po të mundshëm, të ngarkesës praktike. Lidhur me këtë sugjerim drejtuesit e fakultetit dhe departamentit na thanë që pengesa për realizmin tij kishte të bënte me ruajtjen e raportit ligjor midis kategorive të aktiviteteve A, B, C, D, E. Duke marrë shkas nga kjo situatë si dhe situata të ngjashme në IAL e tjera, GVJ sugjeron nga ana e tij që të konsiderohet veçoria e programeve me karakter profesional për këtë raport.</p> <p><i>*LIGJ Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “për kornizën shqiptare të kualifikimeve”</i> <i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</i> <i>Evidenca 12 Plani i zhvillimit strategjik UAMD 2020-2025</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Nw aktet rregullatore të UAMD, posaçërisht në rregulloren e PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” janë përcaktuar objektiva të qartë për formimin profesional të studentëve. Po kështu kurrikula e këtij PS përfshin lëndë dhe aktivitete që synojnë të përçojnë tek studentët dije, aftësi dhe kompetenca që e kompletojnë atë për të ushtruar me zotësi profesionin e fituar. Në shqyrtimin e kurrikulës, GVJ konstaton që kompozimi i saj është bërë duke patur në vëmendje përgaditjen e specialistëve të aftë për tregun e punës si brenda edhe jashtë vendit. Statistikat e punësimit dhe kërkesat e studentëve për këtë profesion e konfirmojnë këtë.</p> <p><i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka</p>	<p>Kurrikula e këtij programi studimi ka të përcaktuar ngarkesën në</p>

<p>të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>kredite për të gjitha lëndët dhe veprimtaritë e kategorive A, B, C, D, E, ku përfshihen lëndët bazë, lëndët karakterizuese, lëndët ndërdisiplinore, lëndët plotësuese dhe detyrimet përmblyëse. GVJ mendon se kjo kurrikulë është funksionale dhe e hartuar në plotësim të detyrimeve ligjore. Ai po ashtu mbështet sugjerimin e studentëve dhe dakordësinë e personelit akademik për të patur më shumë fleksibilitet në reduktimin me argumentim të njohurive teorike në interes të shtimit të veprimtarive praktike si dhe sugjeron përfshirjen e një lënde për njohuritë bazë të teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD është IAL me status publik. Si i tillë edhe forma e organizimit të studimeve, edhe pranimi i tyre edhe financimi i universitetit realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë duke konsideruar specifikat përkatëse, të përcaktuara në gjithë kuadrin ligjor të Ministrisë së Arsimit.</p> <p><i>Evidenca 11 Ligj Arsimit larte 80-2015</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>UAMD ofron 8 programe mbështetur në nivelin e 5 të KSHK, njëri prej të cilëve është dhe “Hidroteknikë Ujësjetës Kanalizime”. Fushet e studimit të këtyre programeve janë të ndryshme prandaj nuk kërkohet plotësimi i këtij kriteri</p> <p><i>*LIGJ Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “për kornizën shqiptare të kualifikimeve”</i></p> <p><i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>RVB:</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Ky kriter plotësohet si detyrim ligjor për të gjithë programet e studimeve të miratura nga MARS.</p> <p><i>*LIGJ Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “për kornizën shqiptare të kualifikimeve”</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që PS “Hidroteknikë Ujësjetës Kanalizime” është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe funksionon mbështetur në to dhe aktet e brendshme rregullatore. GVJ mbështetur në sugjerimin e studentëve dhe dakordësinë e personelit akademik vlerëson që të shikohet mundësia e rregullimit ligjor për reduktimin e njohurive teorike në interes të shtimit të veprimtarive praktike për specifikat e këtyre programeve</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Niveli i përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore që përmmban PS “Hidraulikë, Ujësjellës Kanalizime” është Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP) ndërsa njësia bazë është Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID). Të dyja këto njësi e referojnë aktivitetin e tyre në të drejtat dhe detyrimet që përcakton kadri ligjor për to. Organizimi i programit disiplinohet në zbatimin e aktiviteteve mësimore të përcaktuara në kurrikulën e programit, e cila ishte hartuar duke konsideruar si detyrimet ligjore ashtu edhe rezultatet e problematikave konkrete. Struktura akademike përfshinte PAE, PAK, personelin ndihmës akademik dhe administratën. Për të gjithë strukturën akademike dhe administrative egzistonte dokumentacioni i arkivuar sipas kërkesave ligjore ku përfshihej edhe vlerësimi i aktiviteteve dhe kontributeve. GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuese</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në dosjen e VV, evidenca 43 përmmban të dhëna mbi personelin e 4 departamenteve të FSP. Personeli i përgjithshëm i DSHID është 46 të punësuar nga të cilët PAE 14, PAK 30 dhe personel administrative 2. Nga 14 PAE me tituj dhe grada shkencore janë 5. Po kështu nga 30 PAK, 5 janë me tituj dhe grada shkencore. Sa i përket strukturës moshore të DSID, GVJ konsultoi evidencën 44 dhe gjeti që nga 44 PAE+PAK 16 janë në moshën 55 deri 65 vjeç. Në takimin me personelin akademik GVJ mësoi që ata ndjeheshin të motivuar në angazhimin e tyre ndërsa tek zyra e Burimeve Njerzore, GVJ shqyrtoi disa dosje me zgjedhje për PAE dhe PAK dhe konkludoi që dosjet ishin të plota në dokumentacion sipas kërkesave ligjore.</p> <p>Mbështetur në këto të dhëna GVJ konkludon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuese</i> <i>Evidenca 43 Personeli 4 Dep të FSP</i></p>

	<i>Evidenca 43 Personeli DSID - te dhena + kualifikim RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në takimin me përgjegjësën e DSID dhe Dekanin e FPS si dhe në takimin me studentët, GVJ mësoi që për çdo PS kishte koordinatortë cilë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Koordinatorët për vitin 2021-2022 ishin caktuar me vendimin e Departamentit nr.1, datë 07.10. 2021. Për zhvillimin e praktikave mësimore shfrytëzoheshin lidhjet me biznesin. Kështu GVJ konsultoi kontratën me UKD, pranë së cilës kryheshin praktikat mësimore të studentëve të PS «Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime». Nga UKD kishte pedagogë të angazhuar si PAK të cilët angazhoheshin edhe me kryerjen e praktikave nga studentët. <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 41 Plani mësimor dhe tabela e veprimtarive formuse Evidenca 46 46_Koordinatorët-Vendim DSID_1, 07.10.2021 Evidenca 34, 35, 36 Marreveshje UKD Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 RVB: Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që si FSP (njësi kryesore) ashtu edhe DSID (njësi përgjegjëse) në aktivitetin e tyre përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ u interesua për të konsultuar të gjitha informacionet që lidhen me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” si kurrikulën e programit, stafin akademik, syllabuset e lëndëve/moduleve, kontratat për kryerjen e praktikave etj. Në përfundim ai konkludon që këto informacione disponohen nga DSID, çfarë do të thotë përmbushje e këtij kriteri. <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 41 Plani mësimor dhe tabela e veprimtarive formuse Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP Evidenca 44 Personeli DSID Evidenca 52 Kurrikulë e re HUK Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i>

	<p><i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konsultoi DVV, evidencat 41; 52 të së cilës përmbajnë planin mësimor. Në këtë plan përfshiheshin të gjitha informacionet për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore për çdo lëndë në kredite dhe në orë mësimore në auditor e jashtë auditorit. Nga të gjitha të dhënat rezultojnë plotësimi i kërkesave ligjore si për raportet teori praktikë në masën 50% me 50%, tipet e veprimtarive në kategoritë A, B, C, D, E, shpërndarjen e ngarkesës në auditor e jashtë tij etj. Në takimin me stafin akademik u sugjerua reduktimi i lëndëve teorike në interes të shtimit të ngarkesës në lëndët praktike.</p> <p><i>*LIGJ Nr. 23/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve"</i> <i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në takimin me studentët GVJ mësoi që ata ishin të informuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në PS "Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime". Po ashtu ata ishin të informuar edhe për procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ata u shprehën gjithashtu se kishin mësuar për procedurat edhe nga përvoja e të diplomuarve që kishin vazhduar studimet apo ishin punësuar jashtë shtetit. Konsultimi i rregullorëve të UAMD, FSP, DSID dhe asaj të PS HUK konfirmon që këto informacione janë mbështetur në legjislacionin përkatës.</p> <p><i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet</p>	<p>Në DVV, evidenca 54, GVJ konsultoi praninë dhe përmbajtjen e syllabuseve për të gjitha lëndët/ modulet. Nga ky konsultim rezultojnë se syllabuset janë shkruar për të gjitha lëndët/ modulet. Ato përmbajnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e lëndës • Titullari • Ngarkesa në kredite • Tipologjia • Semestrin kur zhvillohet lënda

e miratuara.	<ul style="list-style-type: none"> • Lloji i lëndës • Kodi i lëndës • Posta elektronike e titullari • Njohuritë paraprake që duhet të ketë student • Njohuritë që merren në këtë lëndë • Temat që do zhvillohen • Ngarkesa ECTS në auditor dhe jashtë auditorit e shpërndarë në komponentët: leksione, ushtrime, seminare laboratore, praktike lënde, projekte, detyra) • Format dhe metodat e mësimdhënjes • Format e vlerësimit • Detyrimet e studentit • Literatura bazë dhe ajo ndihmëse <p>Nga takimi me studentët, GVJ mësoi se ato informoheshin me përmbajtjen e syllabusit qysh në orën e parë të aktivitetit mësimor.</p> <p><i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>								
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	<p>PS "Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime" është hapur për herë të parë në vitin 2013-2014. Riorganizimi i parë i programit në masën deri 20% është bërë në vitin 2018. Nga takimi me personelin akademik, GVJ u informua se duhen ndërmarrë edhe ndryshime të tjera lidhur me shpërndarjen e ngarkesës për ti dhënë më shumë peshë formimit profesional. Këto ndryshime do të ndërmerren pas akreditimit konform dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1 Urdher për hapjen e programit HUK-201</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuese</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>								
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që PS është i detajuar në përmbajtje, është informues në njohuri, është i strukturuar në kompozim dhe është i organizuar metodikisht në përputhje me objektivat formuese të PS "Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime."</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e	Referuar DVV, me përqëndrim tek plani mësimor, në analizë të

<p>veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>veprimtarive mësimore dhe shqyrtim të shpërndarjes së lëndëve e praktikave, GVJ konstaton që si emërtimi ashtu edhe përmbajtja e veprimtarive mësimore, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve. Këtë e konfirmojnë treguesit e shkallës së punësimit brenda vendit (rreth 60%), punësimet jashtë vendit (indikatori tërheqja e suplementit të diplomës) por edhe pohimet e studentëve gjatë takimit që GVJ pati me to. Psh një student, i cili ishte edhe i punësuar, pohoi që njohuritë që mernte gjatë kohës së studimeve ishin mjaft të vlefshme për profesionin që ai e ushtronte ende pa filluar studimet.</p> <p><i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuese</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë konsultimit me dokumentacionin e DVV, GVJ u njoh hollësisht me kompozimin e planit mësimor në lëndë përkatësisht module, shqyrtoi shpërndarjen e tyre na vite/ semestra, ngarkesën përkatëse sipas aktivitetit mësimor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, paraktika etj) dhe konstaton që ky kompozim dhe kjo shpërndarje mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p> <p>Për ta përmirësuar më tej planin mësimor, GVJ rekomandon përfshitjen në të të një lënde që jep njohuritë bazë të teknologjisë së informacionit dhe konsiderimin e një rishpërndarje të ngarkesës së lëndëve përkatësisht moduleve duke u mbështetur edhe në analizën për riorganizimin e PS pas akreditimit</p> <p><i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuese</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e</p>	<p>Nga evidenca 41 e DVV rezulton që, si për tipin e veprimtarisë mësimore (klasifikimi i tipologjisë së lëndëve/ moduleve) ashtu edhe për raportin teori/ praktikë janë zbatuar standartet e kërkuara në %. Po ashtu në planin mësimor është ruajtur standardi që rreth 25% e programit t'i dedikohet aftësimit në praktikë/ punë konkrete në profesion. Në takimin me studentët GVJ u informua që praktika në profesion kryhet në bashkëpunim me biznesin dhe u shërben atyre kryesisht për ti ballafaquar njohuritë e marra me rezultatet, të cilat kënaqin kërkesat e biznesit. Sugjerimi i studentëve ishte të shtohej ngarkesa e praktikave duke reduktuar ngarkesën në lëndët teorike.</p>

<p>përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p><i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të PS Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime janë klasifikuar sipas tipologjisë së lëndëve/moduleve duke respektuar peshën në % të përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 . Konkretisht lëndët e formimit bazë zënë 15%, të formimit karakterizues të profesionit 53%, ato ndërdisiplimore integruese dhe me zgjedhje 13%, plotësuese 13% dhe detyrimet pëmblyëse 5%. Të gjitha këto veprimtari zhvillohen në forma teorike dhe praktike të mësimdhënjes si leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra e projekte kursi, seanca praktikash dhe praktikë profesionale. GVJ vlereson që për PS Hidroteknikë, Ujësjellës kanalizime si veprimtaritë formuese ashtu edhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Dëshmi për këtë janë shkalla e punësimit dhe realizimi i rekrutimeve në masën e kontigjenteve të planifikuara.</p> <p><i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas kërkesave të dizenuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.1.2018, shtojca 2. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për përditësimin e tyre mënyrë të vazhdueshme duke pasqyruar kërkesat e tregut të punës. Specifike për PS Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime është konsiderimi në përditësimin e syllabuseve i sugjerimeve të të diplomuarve në këtë PS, të cilët kanë ekuivalentuar studimet e tyre jashtë apo janë punësuar jashtë vendit. Gjatë shqyrtimit të përmbajtjes së syllabuseve konstatohet që për çdo rast jepet literatura bazë dhe ajo ndihmëse e përditësuar.</p> <p><i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i</p>	<p>Në DVV janë dokumentuar rreth 70 marrveshje kontraktuale bashkëpunimi të UAMD me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda e jashtë vendit, me biznesin dhe me administratën shtetërore.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 20

<p>tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Për PS «Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime» kontratat përmbanin bashkëpunime për praktikat profesionale. Konkretisht GVJ shqyrtoi marrveshjen me ndërmarrjen «Ujësjellës Kanalizime Durrës (UKD)» në administrim të Bashkisë Durrës e cila kishte si objekt kryerjen e praktikës profesionale në mjediset e UKD. Palët ishin dakordësuar të bashkëpunonin për realizimin e kësaj marrëveshje. Në takimin më studentët GVJ mësoi se ata ishin të kënaqur me zhvillimin dhe realizimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 31 Marrëveshje FSP me U Vlore+Luarasi+Kolegji prof. TR</i> <i>Evidenca 34, 35, 36 Marrëveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>RVB; Minuta takimit në UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi dy indikatorë: atë të punësimit brenda vendit (rreth 60%) dhe të kërkesave të studentëve për suplementin e diplomës për të ekuivalentuar studimet e tyre jashtë vendit. Të dy këta indikatorë tregojnë se përbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p> <p><i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimit në UAMD</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që organizimi, struktura dhe përbajtja e PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret

Vlerësimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 21

<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatja sa më mirë me kërkesat e tregut të punës është detyrë e përhershme e njësisë përgjegjëse që në rastin e PS “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” është DSID. Në takimet që pati GVJ me përgjegjësen e Departamentit, me NjSBC dhe personelin akademik u informua për nevojat e ndryshimeve në kurrikulën e programit. Ata pohuan që këto nevoja lindin vazhdimisht në përgjigje të kërkesave të tregut vendas të punës dhe përfaqsen sa më të mirë me programe të njejtë jashtë vendit dhe, ndryshimet e lejuara nën masën 20%, janë ndërmarrë herë pas here por, një rishqyrtim dhe përmirësim i përmbajtjes për riorganizim të programit do të behët pas rezultateve të areditimit.</p> <p>Në këtë kuadër GVJ rekomandon përfshitjen në programin e studimit “HUK” të një lënde që jep njohuritë bazë të teknologjisë së informacionit dhe konsiderimin e një rishpërndarje të ngarkesës së lëndëve përkatësisht moduleve duke u mbështetur edhe në analizën për riorganizimin e PS pas akreditimit.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 31 Marreveshje FSP me U Vlore+Luarasi+Kolegji prof. TR</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 44 Rregullaore e SBSC</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>Evidenca 70 70_Marreveshje me Universitete jashte vendit</i> <i>Evidenca 73 73_Rezultate anketimi 2018-2019</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Ne takimin me personelin e zyrën së Alumni-t GVJ u informua që UAMD mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin e sugjerimeve të tyre kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Veçanërisht të dobishme ishin sugjerimet e të punësuarve jashtë vendit pasi transmetonin përvojën e tyre konkrete në përpjekjet për të siguruar vende pune.</p> <p><i>Evidenca 73 Rezultate anketimi 2018-2019</i> <i>Evidenca 105 Rregullore DASHA sektori komunikim, ALUMNI</i> <i>Evidenca 141 Shoqata Alumni UAMD</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.</p>	<p>DSID si njësi përgjegjëse e PS Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” konsideronte për përmirësimin e programit të studimit propozimet e PAK-ve, veçanërisht atyre që vinin nga ndërmarrje partnere si UKD. Po ashtu propozimet e PAE që në punën e tyre kualifikuese e kërkimore-shkencore konstatonin nevoja për ndryshime përmirësuese. Gjithashtu me shumë interes konsideroheshin edhe propozimet e sugjerimet e studentëve të Alumni-t që vinin me përvojat e tyre si nga tregu vendas i punës ashtu edhe nga ai jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 44 Rregullaore e SBSC</i></p>

	<i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2 Evidenca 105 Rregullore DASHA sektori komunikim, ALUMNI Evidenca 141 Shoqata Alumni UAMD RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të PS "Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime" dhe realizimin me sukses të objektivave të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit dhe konsultimit të DVV për PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” GVJ mësoi për format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive. Këto forma, bazuar në rregullimet ligjore për programet e studimit me karakter profesional janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet dhe praktikat profesionale. Në kurrikulën e programit për sejcilën nga këto forma mësimdhënie janë dhënë kredite ECTS, ngarkessa e të cilave është shpërndarë duke respektuar tipologjinë e lëndëve, raportet teori praktikë dhe ngarkesën në auditor e jashtë auditorit. GVJ vlereson që këto raporte janë ruajtur konform rregullimeve ligjore dhe kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Sa u përket formave, mënyrave, metodave e mundësive të mësimdhënjes GVJ vlereson se ato në përgjithësi u përgjigjen kërkesave e nevojave të studentëve. Pedagogët, në gjykimin e studentëve, ofrojnë të gjitha materialet e duhura për zhvillimin sa më efektiv të formave mësimore. Në dispozicion të studentëve ishin vënë leksionet e shkruara. Biblioteka e institucionit ofronte literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme për zgjerimin dhe plotësimin e njohurive për të gjitha lëndët. Në këtë drejtim GVJ konstatoi dy mangësi të njohura edhe nga personeli akademik dhe të shtrura për zgjidhje edhe nga ana e tij: mungesën e videoprojektorëve dhe kompjuterave të paisur me programe grafike, veçanërisht AutoCad. Këto probleme ishin vënë në rrugën e zgjidhjes dhe GVJ vlereson se ato do të zgjidhen shpejt.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP</i> <i>Evidenca 44 Personeli DSID - te dhena + kualifikim</i> <i>Evidenca 47 CV pedagog HUK, Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore.pdf</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet me personelin akademik, me drejtuesit e institucionit dhe me studentët, GVJ u informua për masën e mbështetjes së personelit akademik dhe ndihmës akademik në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

<p>kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të nevojave të studentëve. Në përgjigje të interesimit të tij, GVJ vlerëson se mbështetja në këtë drejtim jepet nëpërmjet përzgjedhjes së trupës akademike, rritjes së shkallës së kualifikimit të saj, informimit për shkallën e pëlqyeshmërisë nga ana e studentëve, marrjen në konsideratë dhe plotësimin e kërkesave të tyre etj. GVJ gjykon që kjo mbështetje duhet të forcohet edhe më tej nëpërmjet sigurimit të paisjeve didaktike bashkëkohore, pasurimit të laboratorëve me teknologjinë e duhur dhe përmirësimin të infrastrukturës për trajtimin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP</i> <i>Evidenca 44 Personeli DSID - te dhena + kualifikim</i> <i>Evidenca 47 CV pedagog HUK: Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore.pdf</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>Evidenca 71 Mobiliteti staf+stud UAMD</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Duke analizuar tabelat ku pasqyrohen shkalla e kualifikimit të personelit të angazhuar me PS “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime”, struktura moshore e tij dhe raporti PAE/ PAK, GVJ konstaton përmbushjen e këtij kriteri sipas standardeve të kërkuara në nivel kompetencash për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Metodatat e përdorura prej tyre për mësimdhënien ishin të pëlqyera prej studentëve pasi ata, nëpërmjet anketimeve, shprehnin mendimet e tyre edhe për sugjerime edhe për kritika. Edhe studentët ishin në mbështetje të kërkesave të pedagogëve për plotësimin e teknologjisë didaktike dhe bazës laboratorike.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP</i> <i>Evidenca 44 Personeli DSID - te dhena + kualifikim</i> <i>Evidenca 47 CV pedagog HUK: Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore.pdf</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>Evidenca 71 Mobiliteti staf+stud UAMD</i> <i>Evidenca 73 Rezultate anketimi 2018-2019</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e</p>	<p>DSID, njësia përgjegjëse për PS “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime”, vlerëson dhe përmirëson format e mësimdhënies duke konsideruar pëlqyeshmërinë e studentëve, kërkesat e pedagogëve, vlersimet e praktikave profesionale të studentëve dhe sugjerimet e studentëve të Alumni-t. Të gjitha këto konsiderime reflektohen në hartime të plan veprimeve periodike për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</p>

tyre.	<p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 47 Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore</i> <i>Evidenca 71 Mobilitei staf+stud UAMD</i> <i>Evidenca 73 Rezultate anketimi 2018-2019</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton që UAMD ka oragnizuar njësi në nivel institucional të tilla si NjsSBC, GVB, Zyrën e kurrikulës dhe karrierës, zyrën e projekteve Alumni-n etj, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore dhe bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Në takimet me këto njësi GVJ u informua për procedime konkrete lidhur me angazhimin e tyre si dhe rezultatet e arritura në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ndikim në këtë drejtim ka patur dhe bashkëpunimi me biznesin i cili ka ofruar, si me thënë, laboratorë natyralë, ku studentëve u janë demonstruar përdorimet e teknologjive bashkëkohore.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e SBSC</i> <i>Evidenca 47 Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore</i> <i>Evidenca 73 Rezultate anketimi 2018-2019</i> <i>Evidenca 79 Botimet shkencore Pedagog HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metoda e parktika funksionale që sigurojnë arritjen e rezultateve. GVJ gjykon se në këtë drejtim duhet të vazhdohet më plotësimin me teknologji audiovizive (videoprojektorë), kompjutera me programe grafike (AutoCAD) si dhe laboratore të dedikuar. Theksojmë se këto përmirësime ishin në vëmendje të strukturave përgjegjëse.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konsultoi e Rregulloren e UAMD, Rregulloren e DSID-së dhe FSP si rregulloren e programit të studimit, -së dhe konstaton që ato përmbajnë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Këto rregullore ishin bërë publike dhe njiheshin nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>								
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi syllabuset e lëndëve dhe konstaton që ato përmbajnë metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Nga takimi me studentët GVJ u informua që ato u bëheshin të njohura studentëve nga titullari i lëndës me fillimin e procesit për çdo lëndë përkatësisht modul. Të pyetur për objektivitetin e vlersimit studentët u përgjigjën që ai ishte objektiv.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>								
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve, tek rubrika “Kontroll i vazhdueshëm”, për çdo lëndë jepet mënyra e testimit dhe vlerësimit duke marrë në konsideratë specifikat e lëndës. GVJ kostatoi që studentët ishin të njohur me mënyrën e testimit dhe vlerësimit paraprakisht por informacioni u risfreskohej atyre edhe në prag të testimit përkatësisht vlersimit.</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD ka hartuar rregullore dhe procedura të testimit e vlersimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve dhe garanton zbatimin e tyre.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1489 821 1579">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="821 1489 1029 1579">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1029 1489 1220 1579">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1220 1489 1410 1579">Përmbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1579 821 1644"></td> <td data-bbox="821 1579 1029 1644"></td> <td data-bbox="1029 1579 1220 1644"></td> <td data-bbox="1220 1579 1410 1644">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo						
			X						

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e</p>	<p>PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” ka filluar të zbatohet qysh nga viti 2013-2014. Në vitin 2018 është bërë riorganizmi i tij. Gjatë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 27

<p>njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>këtyre viteve janë diplomuar në këtë PS dhjetra studentë që janë punësuar edhe në tregun e brendshëm edhe atë jashtëm të punës. GVJ shqyrtoi kurrikulën e këtij program dhe konstaton që ajo është e ngjashme me programe të tjera të këtij karakteri brenda e jashtë vendit. Bazuar në të gjitha këto GVJ vleron plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 1 Urdher per hapjen e programit HUK-2013.</i> <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 52 V Senati_15. 28.03.2022_HUK riorg</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>Evidenca 70 Marreveshje me Universitete jashte vendit</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Sa i përket plotësimin të këtij kriteri, GVJ gjykon përmbushjen përgjithësisht të tij, pasi në kurrikulën e këtij programi nuk ka lëndë që japin njohuri mbi teknologjinë e informacionit. Kjo edhe mund të justifikohet me karakterin profesional të tij. Sidoqoftë GVJ rekomandon që të shikohet kjo mundësi duke patur përjasje me programe sivëllezër brenda e jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 52 V Senati_15. 28.03.2022_HUK riorg</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>Evidenca 70 Marreveshje me Universitete jashte vendit</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Studentët, edhe në këtë PS, njihen me kurrikulën dhe marrin qysh në fillim syllabusin e lëndës. Pra, për çdo lëndë ata kanë mundësi të ndjekin ecurinë e programit sipas syllabusit. Në takimin me NjsBC, GVJ mësoi që një nga pyetsorët që u jepeshin studentëve lidhej me vlersimet e tyre për lëndën. Në këtë kuadër personeli akademik ka vazhdimisht sugjerime, propozime dhe komente të studentëve për PS dhe syllabuset të cilat ai i merr në konsideratë për të reflektuar. Kjo e ndihmon atë që të vërë në pah edhe çështjet më të rëndësishme dhe t'i orientojë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> <p><i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash</p>	<p>UAMD kishte nënshkruar rreth 70 marrveshje bashkëpunimi me homologët e tij brenda e jashtë vendit, me biznesin, kryesisht brenda</p>

<p>që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>vendit si dhe me administratën (bashkitë) për shkëmbim përvojash, angazhim personeli si PAK, kryerjen e praktikave profesionale dhe mbykqyrjen e tyre etj. Po ashtu institucioni kishte vënë në dispozicion të kësaj PS laboratorin e dedikuar. Të gjitha këto mundësi krijojnë bindjen që mësimdhënia zhvillohet duke i konsideruar ato, në mënyrë që studentët të zhvillojnë njohuritë e marra. Nga ana e tij personeli akademik bashkëpunon si në kuadër të marrveshjeve ashtu edhe nëpërmjet kontakteve personale për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve për çështje të caktuara.</p>		
	<p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 41 Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2</i> <i>Evidenca 70 Marreveshje me Universitete jashte vendit</i> <i>Evidenca 92 Tabela laborator-prog studimi</i> <i>Evidenca 97 Marreveshje FSP dhe FTI_21.04.2020</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë specifikat e këtij PS, PAE dhe PAK realizonin mësim të hapura në ambientet e sipërmarrjeve të specializuara për ujësjellës kanalizimet si UKD, UKV etj. Në këto orë mësimore studentët njiheshin konkretisht me zhvillime të reja, kryesisht të teknologjisë.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që program i studimit "Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime" garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato. GVJ sugjeron përfshirjen në programin e studimit edhe të njohurive bazë të teknologjisë së informacionit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para</p>	<p>UAMD nëpërmjet miratimit të rregullores së programit të studimit për PS "Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime" ka përcaktuar procedura të posaçme për detyrimet përmbyllëse, të cilat i bën publike para</p>

<p>realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>realizimit të tyre. Komisioni i posaçëm që ngrihet për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin në testimin e njohurive të dhëna gjatë vitit akademik të gjitha lëndët, në bazë të rëndësisë e peshës specifike të tyre. Në hartimin e tezave të provimit përfundimtar angazhohen të gjithë pedagogët e lëndëve dhe bëhet pikëzimi sipas pyetjeve. Vlera më e madhe e pikëve u jepet lëndëve karakterizuese për profesionin. GVJ konstaton përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV si dhe na takimet me drejtuesit e njësive, personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi që strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët për detyrimet përmbyllës duke u vënë në dispozicion atyre informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm që ngrihet për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin në testimin e njohurive të dhëna gjatë vitit akademik të gjitha lëndët, në bazë të rëndësisë e peshës specifike të tyre. Në hartimin e tezave të provimit përfundimtar angazhohen të gjithë pedagogët e lëndëve dhe bëhet pikëzimi sipas pyetjeve. Vlera më e madhe e pikëve u jepet lëndëve karakterizuese për profesionin. GVJ konstaton përmbushjen e këtij kriteri</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Për PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” detyrimi përmbyllës bëhet me provim të përgjithshëm dhe jo me tema të udhëhequra prej pedagogëve.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë</p>	<p>Për PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” detyrimi përmbyllës bëhet me provim të përgjithshëm dhe jo me tema të udhëhequra prej pedagogëve.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 30

të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	<i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK RVB Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas rregullores së PS “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime” në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrim përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Për programin e studimit 2-vjeçar “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime” referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime” në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit 2-vjeçare shoqërohen me suplementin e diplomës, e cila është kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 51 Suplement_HUK_2019-2020 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi zyrën e sekretarisë mësimore dhe konstatoi që institucioni ruan, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kopje të dokumentacionit të studentit dhe jep rast pas rasti informacione për studentin nëse ato kërkohen. <i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 51 Suplement_HUK_2019-2020 Evidenca 80 Rregullore sekretarise FSP - 2019 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriteve të këtij standardi, GVJ vlerëson që UAMD ndjek një politikë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në PS “Hidroteknikë Ujësjetllës Kanalizime” dhe e pais atë me dokumentacionin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënjes UAMD ka vënë në dispozicion të personelit akademik platformën online (elearning) dhe udhëzues për përdorimin e saj. Pedagogët u ofrojnë studentëve leksionet e shkruara në web nëpërmjet faqes së katalogimit të bibliotës së UAMD www.catalogonline.uamd.al ndërsa artikujt dhe materialet e tjera shkencore edhe pedagogët edhe studentët i marrin në platformën cobiss. Studentëve u vihen në dispozicion edhe prezantimet që përgadisnin lektorët në adresën e përbashkët elektronike të krijuar nga grupi mësimor i studentëve.</p> <p>www.uamd.edu.al www.catalogonline.uamd.al Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UAMD ka struktura përgjegjëse që zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik si NjSB, Burimet njerzore, GVB. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kontribuojnë pyetorët e studentëve të cilët kërkojnë që studentët të shprehin në kushte anonimatit vlersimet e tyre për lektorët, lëndët dhe infrastrukturën.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e SBSC</i> <i>Evidenca 47 Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 95 Formular Vetevleresimi</i> RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të “Rregullores së PS HUK”, “Rregullores së sigurimit të brendshëm të cilësisë në UAMD” etj GJV konstaton që strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e SBSC</i> <i>Evidenca 47 Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 95 Formular Vetevleresimi</i> RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira,</p>	<p>UAMD, për të forcuar imazhin e institucionit në public ka krijuar faqen online www.uamd.edu.al, si dhe ka hartuar “Strategjinë e komunikimit” e cila jep edhe mënyrën e paraqitjes së arritjeve e rezultateve dhe promovimit të praktikave më të mira për të nxitur</p>

nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	personelin akademik në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. www.uamd.edu.al <i>Evidenca 58 Strategji e komunikimit UAMD</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënjes. Në materialet e vëna në dispozicion në DVV, GVJ nuk gjeti udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe të monitorimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i DVV, takimet në institucion, GVJ konstaton se politika e UAMD është të tërheqë staf të kualifikuar me tituj e grada shkencore, si dhe staf akademik me eksperiencë në fusha specifike, si garanci për realizimin e misionit të UAMD për të diplomuar studentë jo vetëm me formim teorik, por edhe me shprehje dhe aftësi praktike, të gatshëm për të filluar punë në fushën për të cilën janë diplomuar.</p> <p>FSP si njësi kryesore e FSP dhe DSID si njësi bazë mbajnë përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me strukturën akademike dhe organizimin e programit studimor "HUK". Në evidentim të situatës konkrete për përbërjen e personelit akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "HUK" rezulton:</p> <p>Në nivel fakulteti FSP janë 164 antarë të stafit. Nga këta</p> <p>42 janë PAE (23 me grada dhe tituj)</p> <p>117 janë PAK (37 me grada dhe tituj)</p> <p>5 janë personel administrativ</p> <p>Në nivel departamenti për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar:</p> <p>14 PAE (5 janë me grada dhe tituj)</p> <p>30 PAK (5 me grada dhe tituj)</p> <p>2 janë personel administrativ</p> <p>Në nivel program studimi "HUK":</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar:</p> <p>4 staf akademik PAE (1 me titull Dr, 2 me titull Msc, 1 Ark)</p> <p>2 staf akademik PAK (1 me titull MSc)</p> <p>GVJ konsultoi, me zgjedhje rastësore, dosje të PAE dhe PAK të PS "Hidroteknikë Ujësjetës Kanalizime" dhe i gjeti ato të plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i></p>

	<p>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 43 Personeli 4 Dep te FSP Evidenca 44 Personeli DSID Evidenca 47 CV pedagog HUK Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Kurrikula e PS “Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime” përmban 9 lëndë/ module në dy semestrat e vitit të parë me një ngarkesë të përgjithshme prej 60 kreditesh dhe 8 lëndë /module në 2 semestrat e vitit të dytë po me ngarkesë 60 kredite, ku përfshihen edhe praktika profesionale dhe mbrojtja e diplomës. Ngarkesa për lëndët bazë kimi, fizikë, matematikë është semestrale me 4 kredite, ndërsa ngarkesa për të gjithë lëndët e tjera është me 8 kredite. Në rastin e parë ngrakesa në orë mësimore në auditor është 45 orë, në rastin e dytë 90 orë. Referuar udhëzimit të MARS nr. 29 datë 10.09.2018 ku përcaktohet ngarkesa mësimore vjetore në auditor për kategoritë: profesor, lektor, asistent lektorë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme respektivisht: për PAE: 140,165 dhe 195 ndërsa për PAK 120 orë</p> <p>Mbulimi i ngarkesës mësimore:</p> <p>Për vitin 2019-2020</p> <p>Gjithsej 1110 orë 720 PAE 255 PAK 135 personel i UAMD (PAE) Mbulimi nga departamenti PAE 74% PAK 26%</p> <p>Mbulimi në kuadër institucioni PAE 80% PAK 20%</p> <p>Për vitin 2020-2021</p> <p>Gjithsej 1110 orë 720 PAE 255 PAK 135 personel i UAMD (PAE) Mbulimi nga departamenti PAE 74%</p>

	<p>PAK 26%</p> <p>Mbulimi në kuadër institucioni</p> <p>PAE 80%</p> <p>PAK 20%</p> <p>Për vitin 2021-2022</p> <p>Gjithsej 1110 orë</p> <p>630 PAE</p> <p>345 PAK</p> <p>135 personel i UAMD (PAE)</p> <p>Mbulimi nga departamenti</p> <p>PAE 64%</p> <p>PAK 36%</p> <p>Mbulimi në kuadër institucioni</p> <p>PAE 69%</p> <p>PAK 31%</p> <p>Siç shihet mbulimi në kuadër institucioni për 2 vitet e para është në masën 80% PAE dhe 20% PAK ndërsa për vitin 2020-2021 është në kufinj të plotësimit të standardit 69% PAE dhe 31% PAK.</p> <p>Në këto kushte GVJ konkludon në plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Udhëzimi i MARS nr. 29, datë 10.09.2018 "Mbi veprimtarinë dhe ndërkesën mësimore të Personelit Akademik në IAL"</i></p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i></p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i></p> <p><i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 92 Ngarkesa pedagog HUK 2022</i></p> <p><i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në DSID për PS "Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime" zhvillojnë aktivitete mësimore 17 PAE/PAK nga të cilët 13 janë PAE dhe 4 janë PAK. Refruar një kohëzgjatje prej 4 vitesh institucioni ka siguruar përgjithësisht qëndrueshmëri në personel akademik. Në takimin me dekanin, GVJ mësoi që për mungesë të sigurisë në kohëzgjatje të programeve me karakter profesional është e vështirë të sigurohet qëndrueshmëria e PAE, prandaj u sugjerua që për përmbushjen e këtij kriteri të krijohet më shumë hapsirë në angazhimin e PAK.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i></p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i></p> <p><i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 92 Ngarkesa pedagog HUK 2022</i></p> <p><i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Lidhur me procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik në UAMD, GVJ konstaton që ka kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, të cilët garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. DVV përmban “Paketën e BNJ për rekrutim stafi” në të cilën jepen procedura që ndiqet nga shpallja e vendit të punës deri në rekrutimin e personit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konsultoi disa dosje PAE dhe PAK dhe i gjeti ato konform detyrimeve ligjore</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 91 Paketa e BNJ per rekrutim stafi</i> <i>Evidenca 92 Ngarkesa pedagog HUK 2022</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi edhe laboratorët në dispozicion të programit të studimit. Këto ishin të paisura me mjetet dhe teknologjitë e kërkuara dhe administroheshin nga personeli ndihmës akademik, i cili kishte kualifikimin e duhur për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve sipas natyrës specifike të programit të studimit “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime”. Meqë laboratorit i PS “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” dhe ai i PS “Menaxhim ndërtimi” ishin në të njëjtin ambient GVJ sugjeroi ndarjen e tyre.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 91 Paketa e BNJ per rekrutim stafi</i> <i>Evidenca 92 Ngarkesa pedagog HUK 2022</i> <i>Evidenca 92 Tabela laborator-prog studimi</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>Në zyrën e Burimeve Njerzore, GVJ shqyrtoi të dhënat e personelit të angazhuar me PS “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” dhe konstatoi që ato ishin mbledhur, ruajtur dhe përditësuar. Këto të dhëna egzistojnë për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 91 Paketa e BNJ per rekrutim stafi</i> <i>RVB</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në DVV, GVJ konsultoi listën e gjithë personelit të DSID me kohë të plotë e jo të plotë dhe konstatoi që personat e angazhuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale ishin PAK të cilët vinin nga biznesi, duke rritur kështu efikasitetin e praktikave profesionale dhe duke u krijuar mundësinë studentëve të krijojnë lidhje të tilla që në të ardhmen të punësoheshin në këto biznese. Gjatë takimit me personelin akademik mësuam që për studentët që kryenin praktikën profesionale në UKD, sipërmarrja kishte interes për ti punësuar ata pas diplomimit.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 31 Marrëveshje FSP me U Vlore+Luarasi Kolegji prof. TR</i> <i>Evidenca 34, 35,36 Marrëveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Duke qenëse studentët e PS „Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” e kryenin praktikën profesionale të grupuar pranë UKD dhe mbikëqyrja në ambientin pritisë ishte më efiçente. Personeli i angazhuar me marrëveshje i ndihmonte studentët në përmbushjen e detyrimeve (përpilimin e raportit përfundimtar të praktikës). Ata, edhe si PAK, merrnin pjesë në mbrojtjen e diplomës me provim të përgjithshëm.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 31 Marrëveshje FSP me U Vlore+Luarasi Kolegji prof. TR</i> <i>Evidenca 34, 35,36 Marrëveshje UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që personeli akademik dhe ndihmës akademik i cili mbulon PS „Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” përmbush standartet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik e profesioanl për garantimin e standardeve të mësimdhënjes. Referuar situatës së qëndrueshmërisë së PAE në PS me karakter profesional, GVJ sugjeron që të ketë më shumë hapsirë për angazhim të PAK, ndërsa lidhur me rritjen e efiçensës së laboratorëve sugjerohet ndarja e laboratorit të HUK nga ai i ndërtimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 38

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UAMD ka në përdorim dy komplekse akomodimi për veprimtaritë mësimore: tek Currilat dhe kompleksi i quajtur “Kampusi 1”. Në dispozicion të FSP tek kompleksi “Currila” ishin 5 ambiente dhe tek “Kampusi 1” 4 ambiente. GVJ i vizitoi ambientet ku zhvillonin aktivitetet mësimore studentët e PS “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” dhe konstaton që ato ishin të bollshme në sipërfaqe e volum, të paisura me tavolina e karrike si dhe dërrasë të zeze e kodicionerë. Si sallë seminaresh, për të punuar me kompjutera përdorej laborator i informatikës. <i>Për shkak se tek kompleksi “Currilta” qëndrimi prashikohej i përkohshëm, institucioni nuk bënte më investime për ti paisur ambientet me mjete bashkëkohore didaktike si kompjutera, videoprojektorë etj. GVJ e konsideron këtë si një problem për zhvillimin me efikasitet të aktiviteve mësimore.</i></p> <p><i>Evidenca 91 Planimetri + kapac. infrastr. Currila + Kampus 1 - 2022</i> <i>Evidenca 92 Tabela laborator-prog studim</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ky kriter përmbushet pjesërisht pasi institucioni nuk bënte investime në kompleksin “Currila” pasi ishte planifikuar transferimi i aktiviteve tek kompleksi i ri “Korpusi 1”.</p> <p><i>Evidenca 91 Planimetri + kapac. infrastr. Currila + Kampus 1 - 2022</i> <i>Evidenca 92 Tabela laborator-prog studim</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ vizitoi dy laboratore: atë të ndërtimit dhe të eficensës së energjisë, në të cilat zhvillonin punët laboratorike edhe studentët e PS “Hidroteknikë Ujësjiellës Kanalizime” dhe konstatoi që ata ishin të paisur me aparaturat dhe mjetet e bazë të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. GVJ gjykon që në drejtim të paisjes së laboratorëve me teknologji bashkëkohore duhet bërë më shumë. GVJ u informua se DSID do të merrte dhuratë edhe një laborator nga kompania “Sinani” me të cilën kishin marrveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Evidenca 91 Planimetri + kapac. infrastr. Currila + Kampus 1 - 2022</i> <i>Evidenca 92 Tabela laborator-prog studim</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,</p>	<p>Ky kriter përmbushet në përgjithësi pasi edhe pse ambienti ishte vënë në dispozicion mungonin programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit HUK. GVJ rekomandon krijimin e një</p>

të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	laboratory informatike ku të instalohen kompjutera me programe grafike të dedikuara si AutoCAD dhe ArcARCGIS <i>Evidenca 91 Planimetri + kapac. infrastr. Currila + Kampus 1 - 2022</i> <i>Evidenca 92 Tabela laborator-prog studim</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD vë në dispozicion të PS HUK mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik duke e marrë në konsideratë natyrën dhe fushën e PS, por ajo ka disa mangësi që lidhen me pajisjen e këtyre ambienteve me mjete e pajisje bashkëkohore si videoprojektorë, tabela dixhitale etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Litaratura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën shqipe, gjuhë në të cilën zhvillohet programi, afishohet në syllabuset e sejcilës lëndë/ modul. Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ u njoh me praninë fizike të kësaj literature në mjediset e saj si dhe me mundësitë e aksesimit online nga studentët dhe personeli akademik. Platformat për aksesimin e materialeve online ishin: platforma koha, si database elektronike e krijuar nga vetë UAMB, platforma COBISS, U-LIBRARY dhe JSTOR (kjo e fundit deri në fund të vitit 2023). Në takimin me studentët GVJ u informua dhe që materialet mësimore u dërgoheshin studentëve edhe nëpërmjet postës elektronike. Në këto kushte GVJ gjykon se garantohet marrja e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit HUK. https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ www.al.cobiss.net/scripts/cobiss https://ulibrary.rash.al <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1.2 v_2021-2022</i> <i>Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online</i> <i>Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave</i> <i>Evidenca 104 Biblioteka_Praktika per librat, Venera</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në	Gjatë vizitës në UAMD, GVJ vizitoi dhe ambientet e bibliotekës së

<p>dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>institucionit dhe konstatoi që ajo ishte në dispozicion të studentëve duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të gjithë ofertës së saj edhe nga studentët e programit të studimit HUK.</p> <p>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ <i>Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online</i> <i>Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave</i> <i>Evidenca 104 Biblioteka _Praktika per librat, Venera RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UAMD ishte e paisur me tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, si në gjuhën shqipe ashtu dhe gjuhë të huaja, me libra dhe revista shkencore të nevojshme si përmbajtje dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore të PS HUK. Të gjitha këto përfshiheshin në fondin fizik të saj.</p> <p>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ <i>Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online</i> <i>Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave</i> <i>Evidenca 104 Biblioteka _Praktika per librat, Venera RVB</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës që GVJ bëri në mjediset e bibliotekës konstatoi që aty kishte pozicione studimi të bollshme. Për çdo pozicion studimi kishte kompjuter. Ambienti ofronte ËLAN dhe studentët kishin kushte për shfrytëzim të barabartë të aksesit online. Shërbimi për studentët dhe personelin akademik ishte pa pagesë,</p> <p>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ <i>Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online</i> <i>Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave</i> <i>Evidenca 104 Biblioteka _Praktika per librat, Venera RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Të gjitha platformat e ofruara për aksesin online kanë softet e tyre për aksesimin dhe, këto softet mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim të ofertave të platformave për të gjithë studentët.</p> <p>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ www.al.cobiss.net/scripts/cobiss https://ulibrary.rash.al <i>Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online</i> <i>Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave</i> <i>Evidenca 104 Biblioteka _Praktika per librat, Venera RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre,</p>	<p>Gjatë konsultimit të DVV, në evidencën 103, GVJ gjeti një memo ku konfirmohet funksionimi i bibliotekës në fundjavë për shkak se cikli i 2 i studimeve do zhvillohej në fundjavë. Kjo memo është dëshmi e faktit që biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>

në përgjegje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	mësimor. <i>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave Evidenca 104 Biblioteka_Praktika per librat, Venera RVB: Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	Në evidencën 104 të dosjes së vetvlerësimit egzistojnë memo dhe shkresa që konfirmojnë se si biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurimin e fondit fizik dhe atij online. <i>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ Evidenca 89 Manual - Biblioteka Online Evidenca 103 Biblioteka funksionon dhe ne fundjave Evidenca 104 Biblioteka_Praktika per librat, Venera RVB Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që PS HUK përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies. Po ashtu edhe për këtë PS egzistojnë mjedise mbështetëse funksionale si biblioteka e UAMD.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	Referuar RVB, UAMD disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin. GVJ konsultoi faqen e ëeb-it të institucionit dhe gjeti dy sisteme menaxhimi PITAGORA dhe AULA. Sistemi PITAGORA ishte i dedikuar vetëm për studentët e biznesit, ndërsa sistemi AULA ishte i institucionit. Sistemi kishte 6 panele: Administratori, Burimet njerzore, Financa,

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 42

	<p>Pedagogu, Sekretaria, Studenti). Aksesimi në këto panele bëhet i autorizuar dhe me fjalë kyç.</p> <p>https://aula.al/ RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se në të 6 panelet e sistemit AULA administrohet informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmësakademik, dhe personelit administrative.</p> <p>https://aula.al/ RVB Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit AULA në panelet e PEDAGUT dhe STUDENTIT siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>https://aula.al/ RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit AULA ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>https://aula.al/ RVB Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit AULA garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> <p>https://aula.al/ RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi faqen zyrtare të UAMB (https://uamd.edu.al/) dhe konstaton që informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në këtë faqe zyrtare.</p> <p>https://uamd.edu.al/ RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD disponon sistem të menaxhimit institucional dhe e ve atë në dispozicion të administrimit, informimit, dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrative të PS HUK.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar DVV, GVJ konsultoi evidencën nr. 115 dhe konstaton që UAMD (Bordi i Administrimit) harton një raport financiar të kostove ku përfshihen edhe kostot e FSP për programin e studimit HUK dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 115 BA perdorimi i te ardhurave 2021</i> <i>Evidenca 117 tabela kosto huk</i> <i>Evidenca 118 Auditi i brendshem UAMD</i> <i>Evidenca 132 Raporti vjetor UAMD për vitin 2019-2020</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton që në planin financiar për FSP, Bordi i Administrimit ka miratuar financimin e e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 115 BA perdorimi i te ardhurave 2021</i> <i>Evidenca 117 tabela kosto huk</i> <i>Evidenca 118 Auditi i brendshem UAMD</i> <i>Evidenca 132 Raporti vjetor UAMD për vitin 2019-2020</i> <i>RVB</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit</p>	<p>GVJ konsultoi raportin e auditimit të brendshëm (evidenca 118) ku gjendej vlerësimi dhe dokumentimi i gjendjes së financimit dhe efektiviteti financiar i UAMD.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 44

dhe efektivitetin financiar të tij.	<i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 118 Auditi i brendshem UAMD Evidenca 132 Raporti vjetor UAMD për vitin 2019-2020 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nga shqyrtimi i DVV (evidenca 117) rezulton që raportimi i shpenzimeve është bërë për PS HUK. <i>Evidenca 117 tabela kosto huk Evidenca 118 Auditi i brendshem UAMD Evidenca 132 Raporti vjetor UAMD për vitin 2019-2020 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Si Institucion public UAMD garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit të DSID dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. <i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 Evidenca 115 BA perdorimi i te ardhurave 2021 Evidenca 117 tabela kosto huk Evidenca 118 Auditi i brendshem UAMD Evidenca 132 Raporti vjetor UAMD për vitin 2019-2020 RVB Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD harton raport financiar lidhur edhe me PS HUK ku planifikon të ardhurat dhe shpenzimet si dhe nëpërmjet auditimit vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektiviteti financiar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input type="checkbox"/>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV	<input type="checkbox"/>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konsultoi disa nga aktet kryesore rregullatore të UAMD si statutin dhe rregulloren e institucionit e, po ashtu, edhe rregulloren e programit mësimor HUK, vizittoi zyrat që merren me zbatimin e politikave dhe procedurave që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, zhvilloi takimin me studentët e këtij PS dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri në nivelin e kërkesave të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në gjithë linjën e akteve rregullatore të UAMD, politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Konkretisht për pranimin e studentëve, ecurinë e tyre në procesin mësimor, transferimin e studimeve, njohjen e studimeve të mëparshme etj egzistonin praktika që konfirmonin respektimin e barazisë dhe të të drejtave të njëjta edhe për kandidatët edhe për studentit gjatë gjithë kohës së studimeve.</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konsultoi faqen në internet të institucionit www.uamd.edu.al, po ashtu edhe DVV dhe konstaton që UAMD harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Gjatë vizitës në institucion GVJ gjeti praktika të aktiviteteve të zhvilluara në bashkëpunim me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse</p> <p>www.uamd.edu.al <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i></p>

	<p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UAMD www.uamd.edu.al, si dhe në sistemin e menaxhimit të brendshëm AULA gjenden publikime të kriterëve, procedurave të pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit të studentëve përgjatë studimeve, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të cilat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët dhe nga publiku.</p> <p>www.uamd.edu.al www.aula.al</p> <p><i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UAMD www.uamd.edu.al si dhe në aktet rregullore të institucionit gjenden publikime për kriteret e veçanta që vendos institucioni në përzgjedhjen e kandidatëve. Për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara ndiqej praktika e mbështetjes në rregullime ligjore në bashkëpunim me MARS.</p> <p>www.uamd.edu.al <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në vendimin nr. 5, datë 05.02.2021 “Për miratimin e detajimit të përdorimit të të ardhurave të vitit 2021 për UAMD” parashikohen edhe të ardhura për të rimbursuar studentët, në zbatim të politikave të institucionit për akordim bursash për studentët në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit të tyre edhe në PS “HUK”.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 115 BA perdorimi i te ardhurave 2021</i> <i>Evidenca 117 tabela kosto huk</i> <i>Evidenca 132 Raporti vjetor UAMD për vitin 2019-2020</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve,</p>

	<i>transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Për PS "HUK" informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin jepen në rregulloren e programit "HUK". Po ashtu, në kuadër institucioni, prodhohen edhe publikime të posaçme që përmbajnë informacione nga të cilat studentët njihen me kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Një burim i dobishëm informacioni mbetet edhe faqja zyrtare e UAMD www.uamd.edu.al www.uamd.edu.al <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	UAMD e realizon informimin e studentëve në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Në takimin me studentët, GVJ mësoi që në PS "HUK" kishte studentë që vinin nga tregu i punës me kualifikim nga kurset profesionale dhe këto kualifikime u ishin njohur qysh me fillim e studimeve. www.uamd.edu.al <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Edhe në këtë rast burim i dobishëm informimi është faqja zyrtare e UAMD www.uamd.edu.al . Po ashtu informacione në lidhje me

<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive studentët i marrin nga syllabuset e lëndëve, konsultimet me pedagogët dhe kontaktet me sekretarinë. GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>www.uamd.edu.al Evidenca 14 Statuti UAMD Evidenca 15 Rregullore UAMD Evidenca 26 Rregullore FSP Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në aktet rregullatore të institucionit dhe të programit të studimit “HUK” përcaktohen kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit “HUK”. Për PS “HUK” procesi i diplomimit përfundon me vlersimin në provimin përfundimtar.</p> <p>www.uamd.edu.al Evidenca 14 Statuti UAMD Evidenca 15 Rregullore UAMD Evidenca 26 Rregullore FSP Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Për të forcuar imazhin e tij si një institucion akademik, elitar, me kërkim shkencor të standardeve më të larta akademike e në zhvillim të vazhdueshëm, UAMD ka hartuar edhe dokumentin e strategjisë së komunikimit, ku dizajnohen metodat e komunikimit për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit në UAMD. Për ta realizuar konkretisht këtë strategji institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të vazhdueshme si ëorkshop-e, leksione të hapura, biseda me maturantët e shkollave të mesme dhe me biznesin, në mënyrë që të tërheqë në PS sa më shumë kontigjente. GVJ u informua që kuotat për pranimin në PS “HUK” plotësoheshin që në raundin e parë të aplikimeve.</p> <p>www.uamd.edu.al Evidenca 14 Statuti UAMD Evidenca 15 Rregullore UAMD Evidenca 26 Rregullore FSP Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 143 Java e orientimit te studenteve v. 2019 RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Në faqen zyrtare të UAMD www.uamd.edu.al si dhe në aktet rregullatore të institucionit studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. <i>www.uamd.edu.al</i> <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 143 Java e orientimit te studenteve v. 2019</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga dokumentet e DVV, gjatë vizitës në UAMD, në të gjitha takimet e axhendës, veçanërisht në takimin me studentët, GVJ konstaton që institucioni ve në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion, përkatësisht udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Informacione të tilla studentëve u vë në dispozicion edhe faqja zyrtare e UAMD www.uamd.edu.al . <i>www.uamd.edu.al</i> <i>Evidenca 14 Statuti UAMD</i> <i>Evidenca 15 Rregullore UAMD</i> <i>Evidenca 26 Rregullore FSP</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 143 Java e orientimit te studenteve v. 2019</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informacionin mbi mundësitë e punësimit edhe të studentëve të PS “HUK”, studentët, në mënyrë të dedikuar e marrin nga zyra Karrierës dhe e ALUMN-it. Në takimin që pati GVJ me punonjësit e kësaj zyre mësoi për informacionin që kishte kjo zyrë në lidhje me gjendjen e punësimit si dhe të dhënat që ata dispononin për të mbështetur dhe orientuar institucionalisht studentët lidhur me ofertat e tregut të punës. <i>www.uamd.edu.al</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 50

	<p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 140 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune</i> <i>Evidenca 141 Shoqata Alumni UAMD</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Për tu informuar në mënyrë të përditësuar me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të PS studentët kontaktonin faqen zyrtare të UAMD www.uamd.edu.al, sekretarinë mësimore, pedagogët e lëndëve, materialet mësimore të vëna në dispozicion si syllabuset e lëndëve, leksionet e shkruara, frekuentonin bibliotekën e institucionit etj.</p> <p>www.uamd.edu.al</p> <p><i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Praktikat profesionale për PS “HUK» kryhen mbi bazën e syllabusit të hartuar enkas për to. Praktikrat zhvillohen me objektiva konkrete dhe në ndërmarrjet e kontraktuara veçmas për këtë qëllim. Gjatë vizitës në UAMD, GVJ në takimin që pati me personelin akademik me kontratë (i punësuar në UKD) konfirmoi që UAMD kishte marrëveshje të posaçme për praktikrat profesionale. Edhe në takimin me studentët ata pohuan dobinë e kryerjes së praktikës profesionale në biznese që lidheshin me profesionin, duke theksuar edhe faktin që në këtë mënyrë ata krijojnë lidhje që ua lehtësojnë punësimin.</p> <p><i>Evidenca 34, 35, 36 MAREVESHJE UKD 2015, 2019, 2020</i> <i>Evidenca 41, Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuse</i> <i>Evidenca 52 Kurrikula e re HUK</i> <i>Evidenca 54 Syllabuse HUK 1,2 2021-2022</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021-</i> <i>Evidenca 129 Praktika per mentorimet</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>ishet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UAMD disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar për të gjitha programet. Për programin e studimit profesional HUK, të dhënat për studentët e regjistruar e të diplomuar në vite gjenden pranë sekretarisë mësimore. Sekretaria mësimore disponon dosjet për çdo student, të cilat përmbajnë dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e maturës shtetërore, listë notash, kontrata dhe aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, dy fotografi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së ju vunë në dispozicion rregjistri themeltar, regjistri i rezultateve të arritura nga studentet e programit HUK, dhe rregjistri i lëshirimit të diplomave e certifikatave. GVJ konstatoi disa mangësi në to si mungesën e vizës së kuqe pas rrjeshtit të fundit, plotësime me laps të disa rezultateve etj dhe rekomandoi plotësimin e tyre referuar kërkesave të akteve rregullatore. Sa i përket të dhënave për studentët e regjistruar në vite deri në diplomimin e tyre tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik ato disponoheshin, ishin lehtësisht të verifikueshme vetëm nga persona të autorizuar.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 80 Rregullore sekretarise FSP - 2019</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UAMD kishte akses në sistemin menaxhimit të brendshëm «AULA» në panelin e sekretarisë. Në këtë panel menaxhoheshin të dhënat statistikore të studentëve. Hyrja në këtë panel, si edhe në të gjithë panelet e tjerë, kërkonte identifikimin e personit me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin.</p> <p><i>Aula.al</i> <i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 80 Rregullore sekretarise FSP - 2019</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB; Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të</p>	<p>Referuar gjetjeve në rregjistrat që disponon sekretaria mësimore GVJ gjykon që kontrolli periodik duhet të forcohet më tej në mënyrë që mangësitë dhe problemet të ndreqen në kohë.</p> <p><i>RVB</i> <i>Minuta takimi në UAMD</i></p>

dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ gjykon që DSID, si njësia përgjegjëse për PS "HUK" harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre duke konkluduar me marrjen e masave për të përmisuar mangësitë e konstatuara. <i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 80 Rregullore sekretarise FSP - 2019 Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që UAMD mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Duke konsideruar disa mangësi të gjetura gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ rekomandon plotësimin e tyre sipas kërkesave ligjore dhe akteve rregullatore të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në UAMD, studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të institucionit sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Referuar dokumentacionit në DVV si dhe në takimet e zhvilluara, GVJ konfirmon se studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik dhe në komisione të përhershme si NJBSC dhe në Këshillin e Etikës, sipas përcaktimeve në statutin e UAMD-së dhe aktet rregullore, duke garantuar kështu përfaqësimin e tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. <i>Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 44 Rregullore e SBSC Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 Evidenca 127 Vendim keshilla studentore_1, 30.03.2022</i>

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p><i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p> <p>Në UAMD, është ngritur dhe funksionon Këshilli studentor i UAMD (KS UAMD), i cili është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. Edhe njësitë kryesore (fakultetet) kanë KS përkatëse. Këshilli studentor ka rregulloren e tij, ka komunikim institucional me strukturat e tjera në UAMD për të përçuar në mënyrë e drejtpërdrejtë e për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Aktivitetet e KS mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit. Mendimi i studentëve përçohet edhe nëpërmjet mentorimeve. Në evidencën 129 të DVV, GVJ mësoi mendimet që kishin dhënë studentët dhe kontaton se vërejtjet, sugjerimet apo kërkesat e tyre janë me vlerë në interes të mbarëvajtjes së të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në kuadrin e PS “HUK”</p> <p>Edhe gjatë takimit me studentët, ata propozuan më shumë kredite në praktikën profesionale duke reduktuar disa kredite në lëndët bazë (konkretisht fizikën). Sa u përket shërbimit të akomodimit ata sugjerorin ndërtimin sa më shpejt të kampusit universitar për tu krijuar mundësi strehimi në ambiente konvikti.</p> <p>Në zbatim të akteve rregullore të UAMD studentët janë përfshirë edhe në zyrën e Sigurimit të brendshëm të cilësisë, Këshillin e Etikës etj.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e SBSC</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 127 Vendim keshilla studënjore_1, 30.03.2022</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>DSID, si njësi përgjegjëse për PS “HUK”, nëpërmejt akteve të brendëshme rregullore garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Shqetësimet dhe sugjerimet e tyre mbarten në programe pune të departamentit deri në zgjidhjen dhe plotësimin e tyre.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 44 Rregullore e SBSC</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>RVB: Minuta takimi në UAMD</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Si rezultatet e provimit të ndërmjetëm ashtu edhe atij përfundimtar u dërgohen studentëve nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit duke u dhënë mundësinë atyre të shprehen për objektivitetin e vlersimeve. Ata kanë të drejtë ta shohin vlersimin dhe ta diskutojnë atë me vlersuesin (pedagogun). Nëse edhe pas këtij diskutimi studenti nuk bindet për objektivitetin e vlersimit atëherë ai e konteston atë duke paraqitur kërkesë për rivlersim. Kjo kërkesë konsiderohet nga drejtuesit e DSID/FSP dhe merren masa bazuar në aktet e brendshme</p>

njesisë/pedagogut përgjegjës.	rregullatore të institucionit deri sa studenti të bindet për rezultatin e vlersimit. <i>https://aula.al/ Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. GVJ rekomandon që brenda mundësive të konsiderohen sugjerimet e studentëve lidhur me masën e krediteve të praktikës profesionale dhe plotësimin e nevojës së tyre për akaomodim në ambiente konvikti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6



Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në UAMD, mbështetur në aktet rregullatore të tij, janë ngritur njësi të posaçme si zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Po ashtu funksionon dhe sistemi i tutoratit (mentorimit). Ndërsa në linjë administrative në mbështetje të studentëve funksionojnë DSID, FSP, Sekretaria Mësimore. Mbështetje e veçantë u jepet studentëve të PS "HUK" nëpërmjet marrëveshjeve të institucionit me biznesin, ku atyre u sigurohet pritiqe dhe monitorim i dedikuar. <i>Evidenca 14 Statuti UAMD Evidenca 15 Rregullore UAMD Evidenca 26 Rregullore FSP Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 34,35,36 Marrëveshje UKD 2015,2019,2020 Evidenca 80 Rregullore sekretarise FSP - 2019 Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 RVB; Minuta takimi në UAMD</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin,	UAMD ka ngritur dhe ka bërë institucional sistemin e tutoratit (mentorimit) i cili funksionon për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe i ndihmon ata për çështje që kanë të

<p>këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimi. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe Sistemi i Menxhimit të Brendshëm, komunikimi interaktiv pedagog student si dhe faqja zyrtare www.uamd.edu.al.</p> <p>www.uamd.edu.al https://aula.al/ Evidenca 27 Rregullore DSID Evidenca 28 Rregullore e programit HUK Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021 Evidenca 129 Praktika per mentorimet RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacioni e DVV dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u interesua të informohet për funksionimin e Zyrës për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni-n si njësi e posaçme në shërbim të informimit të studentëve dhe konstaton që kjo zyrë mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 140 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune</i> <i>Evidenca 141 Shoqata Alumni UAMD</i> RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësuesit e Njësisë për zhvillimin e Karrierës dhe Alumni-n, GVJ u informua mbi veprimtaritë konkrete të kësaj zyre në ndjekjen e studentëve të PS “HUK” pas diplomimit dhe konstaton që ajo disponon të dhëna për punësimin e tyre dhe ua vë në dispozicion ato studentëve edhe në takimet e posaçme që organizohen prej saj por edhe me kërkesën e tyre. Gjithashtu këto të dhëna ajo i ofron në rrugë institucionale edhe për të tretët.</p> <p><i>Evidenca 27 Rregullore DSID</i> <i>Evidenca 28 Rregullore e programit HUK</i> <i>Evidenca 83 Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021</i> <i>Evidenca 140 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune</i> <i>Evidenca 141 Shoqata Alumni UAMD</i> RVB; Minuta takimi në UAMD</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Duke marrë në konsideratë kohën e funksionimit të programit të studimit “HUK”, qysh prej vitit 2013-2014, si dhe numrin thuajse konstant të frekuentimit të tij, GVJ gjykon që ky programit të studimit ka krijuar fiziononi të qartë dhe pëlqyeshmëri, çfarë garanton vazhdimësi për të ardhmen.
2. Mbështetur në shkallën e punësimit të të diplomuarve në këtë programit të studimit, GVJ gjykon që ai është i mirëpritur nga tregu i punës.
3. Mbështetur në kërkesat e studentëve për të ekuivalentuar diplomën që lëshohet pas përfundimit të këtij programit të studimit, GVJ gjykon që kurrikula e tij u ofron dhe u transmeton atyre njohuri dhe dije që kanë vlerë përdorimi edhe në tregun ndërkombëtar.
4. Duke marrë në konsideratë “urinë” që ka sot tregu i brendshëm i punës (edhe për shkak të emigracionit) GVJ gjykon që do ketë rritje të kërkesave për ta frekuentuar këtë programit të studimit, çfarë mbështet qëndrueshmërinë në kohë të tij.
5. Duke marrë në konsideratë lidhjet që ka ky programit të studimit studimesh me biznesin edhe gjatë procesit mësimor (pritjen, trajtimin dhe vlersimin e studentëve në praktikat profesionale si dhe gadishmërinë e biznesit për ti punësuar studentët edhe gjatë kohës së studimeve) konkludohet që ai do ti mbajë të forta lidhjet me tregun e punës dhe do ta mbajë të vazhdueshëm interesin për të.

Pika të dobta:

1. GVJ konstaton mungesë të paisjeve didaktike si videoprojektorë etj në ambientet ku zhvillohen leksionet si dhe mungesën e një laborator informatike të dedikuar për programet grafike si AutoCAD, ArcGIS etj (problem i ngritur nga studentët) çfarë e ndikon negativisht në efektivitetin e procesit mësimor. **(Standardi IV.2, kriteri 4)**
2. Disa parregullsi në plotësimin e dokumentacionit të studentëve si mugesë e vijës së kuqe në përfundim të listës me studentin e fundit apo plotësimi me laprogramit të studimit i rezultateve të vlersimeve, gjykohen nga GVJ si parregullsi që shkatrajn probleme për ecurimë e procesit mësimor në programin e studimit.

(Standardi V.4, kriteri 1)

Rekomandime:

1. Të shtohet pesha e orëve të praktikave duke reduktuar disi ngarkesat në lëndët e formimit teorik, kryesisht fizikiës (sugjerim i studentëve).
2. Të shihet mundësia e përfshirjes në kurikulë të njohurive bazë për teknologjinë e informacionit.
3. Të bëhen më funksionalë auditorët duke i paisur me mjete e teknologji bashkëkohore (videoprojektorë, tabela elektronike etj).
4. Të ndahet laborator i programit të studimit “HUK” nga ai i programit të studimit “Menaxhim Ndërtimi” dhe të ngrihet laborator i informatikës për aplikacione grafike si AutoCAD, ArcGIS.
5. Të zgjidhet problemi i akomodimit të studentëve nëpër konvikte.
6. Të ushtrohen më shpesh kontrole periodike në sekretarinë mësimore për të mos krijuar probleme që lidhën me mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit bazë të studentëve.
7. Për specifikat e studimeve me karakter profesional si programi i studimit “HUK” të shihet mundësia e liberalizimit të kërkesë për raportin PAE/ PAK në favor të shtimit të peshës së PAK rreth një bërthame të qëndrueshme PAE (sugjerim i dekanit të FSP).

Evaluation's conclusions for the professional study program "Hydro Water Supply and Sewerage" provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" University, Durrës.

Strengths and Affirmations:

1. Taking into consideration the time of operation of program "HUK", since 2013-2014, as well as the almost constant number of its attendance, GVJ judges that this program has created a clear and pleasant function, which guarantees continuity for the future.
2. Based on the employment rate of graduates in this SP, GVJ judges that it is welcomed by the labor market.
3. Based on the students' requests to equate the diploma that is issued after the completion of this program, GVJ judges that its curriculum offers and transmits to them knowledge and knowledge that have value for use in the international market.
4. Taking into consideration the "hunger" that the internal labor market has today (also due to immigration), GVJ considers that there will be an increase in requests to attend this program, which supports sustainability in its time.
5. Taking into consideration the connections that this program of studies has with business even during the learning process (the reception, treatment and assessment of students in professional practices as well as the readiness of business to employ students even during studies) it is concluded that it will keep them strong connections with the labor market and will continue to show interest in them.

Weak points:

1. GVJ finds a lack of didactic equipment such as video projectors, etc. in the premises where the lectures take place, as well as the lack of a computer laboratory dedicated to graphic programs such as AutoCAD, ArcGIS, etc. (problem raised by students), which negatively affects the effectiveness of the teaching process
2. Some irregularities in the completion of student documentation, such as the absence of a red line at the end of the list with the last student or the completion of assessment results with a pencil are judged by the GVJ as irregularities that cause problems for the progress of the learning process at program "HUK".

Recommendations:

1. To increase the weight of practice hours by somewhat reducing the workload in the subjects of theoretical training, mainly physics (suggestion of students)
2. To see the possibility of including basic information technology knowledge in the curriculum
3. To make the auditoriums more functional by equipping them with modern tools and technology (video projectors, electronic boards, etc.)
4. Separate the laboratory of program "HUK" from that of program "Construction Management" and set up a computer laboratory for graphic applications such as AutoCAD, ArcGIS.
5. To solve the problem of student accommodation in dormitories.
6. Periodic checks should be carried out more often in the educational secretariat in order not to create problems related to the maintenance and preservation of the basic documentation of students.
7. For the specifics of studies with a professional character such as program "HUK", see the possibility of liberalizing the requirement for the PAE/PWD ratio in favor of increasing the weight of PWDs around a stable PAE core (suggestion of the dean of FSP).

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X